

Memli Sh. KRASNIQI

SHTETËSIA E KONTESTUAR E KOSOVËS: HISTORIA SI KUAZI-ARGUMENT I PALËS SERBE*

Në këtë punim do të bëhet fjalë se si shteti serb konteston shtetësinë e Kosovës duke përdorur argumente të fabrikuara nga e kaluara, si: “Shpërngulja e madhe serbe”, origjina sllave e toponimit Kosovë dhe Kosova si qendër e krishterimit ortodoks serb. Shteti dhe shoqëria serbe pretendojnë se Kosova është pjesë përbërëse e kujtesës historike serbe duke shfrytëzuar argumente se në hapësirën e këtij territori janë bazamentet e shtetësisë dhe kulturës shpirtërore të tyre. Natyrisht për të përligjur pretendimet e tyre, historiografia serbe pikësëpari përjashton prejardhjen ilire të shqiptarëve dhe përqendrohet vetëm në periudhën e forcimit politik dhe ushtarak të Rascisë apo Rashës (sikur e thërrasin disa studiues) gjatë shekujve XIII-XV, kohë kjo e shtrirjes së tyre në drejtim të jugut të pasur dhe të banuar nga arbërit, gjë të cilën ata e mohojnë, por pa shpjeguar se cilët ishin banorët që e popullonin këtë zonë. Mbretërit e Rashës në zonën e Kosovës meremetuan kishat ekzistuese, ndërtuan mbi themelet e kishave ekzistuese objekte të reja sakrale dhe shtuan presionin për t’i konvertuar në ritin ortodoks me liturgji në gjuhën sllave, jo vetëm të krishterët katolikë, por edhe ata ortodoksë të ritit bizantin.¹ Historiografia serbe kur bënë fjalë për përbërjen etnike gjatë mesjetës së banorëve të Rrafshit të Kosovës dhe të Dukagjinit mbështetet në tezën se të

* Kumtesë e mbajtur në sesionin shkencor “Kosova 15 vjet pavarësi - sfidat dhe shtetformimi”, organizuar në Prishtinë, më 15 shkurt 2023.

¹ Për konvertimin e arbërve katolikë si dhe kthimin e kishave katolike në rashjano-ortodokse bëhet fjalë edhe në nenet e Kodit të Dushanit. Shih: Jahja Drançolli, *Në kërkim të historisë mesjetare arbërore* (Zagreb: Unioni i Shqiptarëve në Republikën e Kroacisë, 2019), 283-284.

gjithë të krishterët ortodoksë dhe ata me antroponomi sllave ishin serbë dhe vetëm një pakicë e krishterë katolike ishte vendase dhe të tjerët ishin të ardhur kryesisht nga Shqipëria Veriore dhe të cilët duke u islamizuar gjatë shek. XVI, XVII, XVIII u bënë shumicë në Rrafshin e Kosovës dhe të Dukagjinit.²

Pra një pakicë etnike me kulturë dhe traditë inferiore në krahasim me serbët dhe nën sundimin e një fuqie të huaj arriti të imponohej dhe me dhunë të bëhej shumicë në Rrafshin e Kosovës dhe të Dukagjinit? Shpjegimi i tillë i proceseve historike sjell përsëri historiografinë serbe në kundërtënie me argumentet e saj. Së pari ata nuk marrin mundin të theksojnë se shqiptarët deri në zgjerimin e mbretërisë serbe në jug i takonin kryesisht krishterimit lindor të ritit bizantin dhe pjesërisht atij perëndimor (katolik).

Së dyti nuk i referohen as burimeve historike ose ato i kapërcejnë kur flitet për shqiptarët e krishterë ortodoksë të Rrafshit të Kosovës dhe të Dukagjinit sikur janë: “Memoria mbi Shqipërinë” të përpiluar nga Marsiglit dhe të mbështetura në të dhëna të klerikut shqiptar Tomë Raspasani; të letërthirrjes së 6 prillit 1690 të Leopoldit I si dhe të dhënave të tjera nga kjo periudhë historike. Studiuesit serbë, si Jovan Tomiq, argumentojnë prezencën e madhe etnike shqiptare në Rrafshin e Kosovës dhe të Dukagjinit vetëm nga shekulli XVII, kur serbët kinse pësuan si aleatë të habsburgasve dhe u detyruan të shpërngulen nga Rrafshi i Kosovës edhe i Dukagjinit dhe që pastaj nën dhunën e shqiptarëve të islamizuar ata jo vetëm u islamizuan, por edhe u shqiptarizuan.³ Mirëpo edhe pse gjatë gjysmës së dytë të shek. XVII dhe fillimit të shek. XVIII procesi i islamizimit të popullsisë së krishterë në Perandorinë Osmane ishte në rritje duke përfshirë rajone të tëra në Shqipëri,

² “*Les Albanais qui firent irruption parmi une population serbe diminuée en nombre, notamment par le grand Exode de 1689-1690, par la guerre et les destructions, étaient des montagnards éleveurs de bétail de l’Albanie du nord, islamisés au cours du XVI^e et du XVII^e siècle.*” Boško I. Bojović, *Église Orthodoxe Serbe (Histoire - spiritualité - modernité)*, 55.

³ “Они су истицани као главни узрок и мухамеданизирању и арнаућењу српског православног становништва са тога терена...” Јован Н. Томић, *О Арнаутима у Старој Србији и Санџаку* (Београд: Просвета, 1995, прво издање 1913), 34. Mjerisht në mesin e atyre që mbronin këtë tezë të historiografisë serbe ishte edhe osmanologu, Hasan Kaleshi, të cilin disa studiues përpiqen ta mbrojnë duke theksuar se ky punim është botuar vetëm pas vdekjes së tij. Shih: Хасан Калеси, *О сеобама Срба са Косова крајем XVII и почетком XVIII века, етничким променама и неким другим питањима из историје Косова,* “Обележја,” година VI, број 4, (Приштина: Јединство, Јул-Аугуст 1976): 193-219.

Serbi, Bosnjë, Bullgari, Dalmaci, përsëri elementi i krishterë ishte mbizotërues.⁴

Pra, për këtë periudhë historike nuk mund të bëhet fjalë për një popullsi shqiptare plotësisht të islamizuar. Në të vërtetë këtij procesi më shumë i ishin nënshtruar të krishterët katolikë, të cilët jo vetëm se kishin qendrën shpirtërore jashtë kufijve të Perandorisë Osmane, por ishin edhe mbështetje e shteteve të krishtera katolike të Evropës në luftën e tyre të pandërprerë me Portën e Lartë.⁵ Studiuesi F. F. Anscombe konsideron se për Perandorinë Osmane ndër grupet etnike-gjuhësore më të rëndësishme ishin shqiptarët (shumë më pak serbët) dhe se me “Arnavudluk” ata quanin të gjitha vendbanimet ku jetonin shqiptarët në shumicë (Shqipërinë, Kosovën, pjesë të Maqedonisë Veriore dhe Malin e Zi) dhe ndonëse nuk kishin krijuar një njësi të veçantë territoriale përsëri “Arnavudluk” konsiderohej një zonë me rëndësi primare për Portën e Lartë.⁶

Studiuesit serbë si argument tjetër në shërbim të tezës së tyre e lidhin etimologjinë e toponimit “Kosovë” dhe “Metohi” me gjuhën serbe. Ata potencojnë se fjala “Kos” është emër serb me të cilin quhet zogu i vogël shtegtar me pupla të zeza apo mëllenja (shq.). Ndërsa Aristoteli në veprën “Historia Animalium” (Historia e kafshëve) nga shek. IV p.e.s, me **κοττύφων** quante zogun me pupla të zeza apo mëllenjën; në Atikë - Athinë, grekët e lashtë, **κόττυφος** (kóttiphos) dhe **κόσσυκος** (kóssikos) quanin zogun e zi apo mëllenjën; në periudhën Bizantine (shek. X-XV) kjo fjalë vazhdonte të përdorej si “κόσσυφος/ κόσσυβος” (kóssyfos).⁷ Prandaj Pjetër Bogdani në

⁴ “Auffallend genug bleibt es dabei immer, daß der Übertritt der Christen im osmanischen Reiche zum Islam um diese Zeit noch immer eher im Zunehmen, als im Abnehmen blieb, nicht nur für einzelne Fälle, sondern auch für ganze Landschaften, namentlich in Europa, in Albanien, Dalmatien, Bosnien, Servien, Bulgarien, wo das christliche Element der Bevölkerung noch bei weitem das vorherrschende war.” Për më shumë shih: Johann Wilhelm Zinkeise, *Geschichte des Osmanischen Reiches in Europa* (Gotha: Bei Friedrich Andreas Perthes, 1857), 319.

⁵ *Dokumente për historinë e Shqipërisë (1623-1653)*, Transkriptuar e përkthyer nga Injac Zamputi (Prishtinë: Faik Konica, 2015), 365, 370.

⁶ Frederic F. Anscombe, “The Ottoman empire in recent international politics- II: the case of Kosovo,” *The International History Review*, 28 (4): 772, 784.

⁷ Memli Sh. Krasniqi, *Kosova (1981-1989): Fillimi i shpërbërjes së RSF të Jugosllavisë* (Prishtinë: Instituti Albanologjik, 2021), 13.

raportin e tij do të shkruante: “**...campo di Cossovo, detto merlino..**” (Fusha e Kosovës, e njohur si fusha e mëllenjave).⁸ Pra nuk është e pritshme që grekët e vjetër, romakët e lashtë dhe italianët kanë huazuar ose përkthyer nga sllavët emrat e shpezëve. Ndërsa se sa janë institucionet serbe të prirura për të ndryshuar toponiminë tregon edhe kërkesa zyrtare e tyre më 1915 që shtypi britanik të mos përdorte më emrin Servi por Serbi.⁹ Gjithashtu vetëm pas vitit 1945 filloi përdorimi zyrtar dhe administrativ i termit Metohi, fjalë kjo që buron nga gjuha greke μετοχή (ndarje, bashkësi) dhe e cila ka kuptimin e pronës së manastireve ortodokse. Prandaj gjatë shekullit të XIX dhe XX, elitat intelektuale dhe politike serbe për të dëshmuar përkatësinë serbe të Kosovës, insistonin në përdorimin e emërimit gjeografik Metohi në vend të atij Dukagjin me të cilën lidhej përkatësia etnike shqiptare e kësaj pjese të Kosovës. Ndërsa emërtimi zyrtar i vilajetit të Prizrenit në vilajet të Kosovës është bërë në vitin 1877, në prag të luftës ruso-osmane.¹⁰

Pika kthesë në historinë e shqiptarëve ishte depërtimi i forcave habsburgase në territorin e Kosovës së sotme. Kështu në fushatën e suksesshme të Pikolominit drejt jugut atij i ndihmoi edhe një legjendë popullore që përflitej në mesin e shqiptarëve dhe boshnjakëve (popullsisë sllave), sipas së cilës, ata do t'i çlironte nga sunduesi osman një princ, devetë e të cilit do t'i kalëronin kafshët e huaja të panjohura, ekzotike. Këtë legjendë e shfrytëzoi shumë mirë Pikolomini, i cili nga kampi i zënë i osmanëve në Nish, solli deve mbi të cilat qëndronin majmunët dhe papagajtë. Dhe në momentin që ai hyri në Prishtinë, ky veprim i tij rezultoi me sukses të madh, sepse duke plotësuar fantazinë popullore, banorët shqiptarë të krishterë të rrethinës dhe të Prishtinës, Pikolominin e përjetuan si shpëtimtar, të cilin aq gjatë e kishin pritur.¹¹ Çka dëshmon kjo legjendë? Së pari kjo gojëdhënë nuk

⁸ Augustino Theiner, *Vetera Monumenta Slavorum Meridionalium*, Tom. II, (Zagrabiae: Academia Scientiarum et Artium Slavorum Meridionalium, 1875), 220.

⁹ *The North Otago Times*, Friday, 5 March 1915, 7.

¹⁰ Memli Sh. Krasniqi, *Kosova (1981-1989)*, 12.

¹¹ “Unter den Bosniern und Albanesen bestand eine alte Sage: sie würden durch einen Fürsten, auf dessen Kameelen fremdländische Thiere reiten würden, von dem türkischen Joche befreit werden. Piccolomini nützte diese Mähre aus und hatte auf Kameelen, die bei Nis erbeutet worden waren, Affen und Papageien mitgenommen, die den beabsichtigten Effect auch sofort in Pristina im vollen Masse thaten.” R. Gerba: *Die Kaiserlichen in Albanien 1689*, 136; Johann v. Csaplovics, *Slavonien und zum Theil Croatien: ein Beitrag*

kishte të bënte me popullsinë e islamizuar shqiptare për të cilët shkëputja nga Perandoria Osmane dhe rënia nën pushtetin e një fuqie të krishtere nuk ishte çlirim, por dëbim ose rikonvertim në krishterim. Së dyti, Pikolomini në raportin e tij do të lajmëronte se në Prishtinë atë e pritën përfaqësuesit katolikë, shqiptarët dhe të tjerë.¹² Pra, është fare i qartë dallimi që ai bënte duke i konsideruar të krishterët katolikë si bashkësi të veçantë dhe në anën tjetër me shqiptarë dhe të tjerë, ai natyrisht nuk nënkupton popullsinë e islamizuar të cilët tashmë ishin larguar, por bashkësinë e krishterë ortodokse të shqiptarëve dhe të rashjanëve.

Mbi përkatësinë e krishterë ortodokse të shqiptarëve të Rrafshit të Kosovës dhe të Dukagjinit dëshmojnë: Memoria mbi Shqipërinë (Memorie su l' Albania), dorëzuar kancelarisë perandorake habsburgase nga L. F. Marsigli, e cila mbështetej në të dhënat e vikarit të Kryepeshkopatës së Shkupit, Tomë Raspasanit,¹³ si dhe letërthirja e 6 prillit 1690 e perandorit habsburgas, Leopoldi I.¹⁴ Në fillim të këtij letërkujtimi mbi Shqipërinë, Marsigli-T. Raspasani thekson se shqiptarët janë të ndarë në gjashtë apo shtatë rrethe të gjithë të ritualit shizmatik (ortodoks), me përjashtim të kelmendasve që janë katolikë.¹⁵ Duke u nisur nga fakti se komanda habsburge kishte pikësynim që të mbyllte brezin tokësor në drejtim të elajetit të Bosnjës nga Shkodra deri në Novi-Pazar, vijmë në përfundim se bëhet fjalë për

zur Völker- und Länderkunde; theils aus eigener Ansicht und Erfahrung (1809 - 1812), theils auch aus späteren zuverlässigen Mittheilungen der Insassen. 2: Enthält: Die orientalische Kirche in historischer, statistischer, hierarchischer und kirchlicher Beziehung; Schulwesen und Literatur der Serbler; Civilgerichtsbarkeiten, Militärgrenze, Verkehr mit den Türken; Anhang: Trenk's Panduren, Nachrichten über die Türken, (Pesth: Hartleben, 1819), 27.

¹² *Oesterreichisch-Militärische Zeitschrift*, Ersten Jahrgang, 2 Heft (Wien: Hof- u. Staatsdr., 1808), 240.

¹³ Österreichische Staatsarchiv, Haus-, Hof- und Staatsarchiv, Illyrico-Serbica (1683-1715), K1/Konv.B, Memorie su'l Albania, Fol. 41r (15r); *Dokumente të shekujve XVI-XVII për historinë e Shqipërisë*, vëllimi IV (1675-1699), përgatitën: Injac Zamputi, Selami Pulah (Tiranë: Akademia e Shkencave të RPS të Shqipërisë - Instituti i Historisë, 1990), 330.

¹⁴ *Dokumente të shekujve XVI-XVII për historinë e Shqipërisë*, vëllimi IV (1675-1699), 334.

¹⁵ *Gli Albanesi sono divisi in sei o sette distreta tutti di rito sismatico, eccetto li Climenti, che professano a perfettamenteamente la fede cattolica romana.* "Österreichische Staatsarchiv, Haus-, Hof- und Staatsarchiv, Illyrico-Serbica (1683-1715), K1/Konv.B, Memorie su'l Albania, Fol. 41r (15r); *Dokumente të shekujve XVI-XVII për historinë e Shqipërisë*, vëllimi IV (1675-1699), 330.

shqiptarë të krishterë ortodoksë banorë të sanxhaqeve të Novi-Pazarit, Vuçitërnës, Prizrenit, Dukagjinit, Shkodrës, Shkupit dhe të Nishit. Natyrisht historiografia serbe e hedh poshtë vërtetësinë e këtij dokumenti, duke pretenduar se Marsigli nuk ka pasur njohuri të saktë mbi përbërjen etnike dhe fetare të këtyre zonave dhe njëkohësisht minimizojnë ose e kalojnë në heshtje kontributin e Toma Raspasanit në përpilimin e këtij dokumenti.

Këto pretendime të tyre i mbështesin edhe studiues të huaj. Ndërsa, në anën tjetër, studiuesit serbë (Mita Kostiq, i cili e boton “Memorien mbi Shqipërinë” duke theksuar si autor Toma Raspasanin, por në punimin e tij shmang të flasë mbi shqiptarët e krishterë ortodoksë të liturgjisë në gjuhën sllave duke këmbëngulur me vetëdije se udhëheqës i kryengritësve shqiptarë të krishterë katolikë ishte Toma Raspasani, ndërsa i të krishterëve ortodoksë apo sipas tij vetëm i serbëve ishte kryepeshkopi i Pejës, patriku Arsenije III Cërnojeviq, Rajko Veselinoviq etj.) dhe të huaj që i mbështesin anashkalojnë edhe të dhënat mbi shqiptarët në proklamatin e perandorit Leopoldi I të 6 prillit 1690. Në këtë letërthirrje, Leopold I i drejtohej të gjithë popujve dhe vendeve në varësi të Mbretërisë së Hungarisë (Kroacisë, Sllavonisë, Bosnjës, Serbisë dhe Bullgarisë) dhe veçanërisht shqiptarëve (*..imprimis vero Populo Albanensi gratiam nostram Caesaream Regiamque et omne bonum*).¹⁶

Në vazhdim të proklamatës ose të deklaratës së shkruar (manifestit) perandori fton të gjithë popujt në Shqipëri, Serbi, Bullgari, Maqedoni, Rasci, që t’i rikthehen bashkimit në kuadër të Mbretërisë së Hungarisë dhe t’i bashkohen përpjekjeve të përbashkëta në luftën kundër pushtimit osman si dhe për lartësimin e fesë së krishterë. Pjetër Mazreku në raportin e tij të viti 1633 thekson se kishte 12 000 të krishterë katolikë në “Mbretërinë e Serbisë” (kisha katolike vazhdonte me ndarjet në njësitë administrative të shekujve të mëhershëm edhe pas pushtimit osman të këtyre zonave) dhe se këta besimtarë të Prizrenit, të Prishtinës, të Novobërdës, të Janjevës, të Trepçës, të Letnicës, të Shkupit, flisnin gjuhën shqipe dhe sllave. Ndërkohë në zonën e Prizrenit në pesë famulli kishin mbetur vetëm rreth 4 000 katolikë me dy priftërinj, ndërsa banorët e 40 e më shumë famullive të tjera ishin islamizuar duke marrë zakone dhe kulturë osmane.¹⁷ Ndërkohë në raportet e Pjetër Bogdanit theksohej se në

¹⁶ *Dokumente të shekujve XVI-XVII për historinë e Shqipërisë*, vëllimi IV (1675-1699), 334.

¹⁷ “...di linguaggio differenti, Albanese, e schiauone...” *Relacione mbi gjendjen e Shqipërisë Veriore dhe të Mesme në shekullin XVII*, Vëllimi I (1610-1634), 436-437, 451; Po kështu

Kosovë (*Intorno à Cossovo vi sono li seguenti luochi*) kishte 1 000 shtëpi të krishtera katolike nga të cilët mund të mbledheshin 3 000 luftëtarë dhe që së bashku me të krishterët ortodoksë apo “serbët” (sikur i quan Bogdani) numri i tyre mund të rritej në 10 000 luftëtarë.¹⁸ Mirëpo më parë duhet shpjeguar se Bogdani me këtë rast ka parasysh kontributin e banorëve sipas përkatësisë fetare (ortodoksët e liturgjisë në gjuhën sllave) dhe jo sipas asaj etnike, sepse në të kundërtën do të potenconte edhe shqiptarët (*Li miei Albanesi...*).¹⁹

-Pika e tretë në të cilën mbështetet historiografia dhe shteti serb është miti mbi kinse “shpërnguljen e madhe serbe nga Kosova më 1690”. Sipas burimeve arkivore vjeneze, më 9 nëntor 1690, baroni Arejzaga (Arreyzaga) lajmëronte Këshillin e Luftës në Vjenë se në rrethinën e Budimës kishin ardhur 15 000 të shpërngulur rashjanë dhe të cilëve inspektori i administratës tatimore (Cameral Inspector) u kishte dhënë leje të vendoseshin në fshatrat e rrethinës së Budimës (Alt-Ofen, gjermanisht) e deri në Visegrad (në veri të Hungarisë).²⁰ Pra jo 37 000 familje sikur pretendon historiografia serbe, por ishin zhvendosur 15 000 banorë nga Rrafshi i Kosovës, i Dukagjinit, luginës së Vardarit, Bullgarisë dhe Serbisë (deri në fund të vitit 1690), gjë që nuk ka ndikuar në ndryshimin e strukturës etnike të popullsisë së Kosovës. Shifra prej 37 000 familjesh të shpërngulura nuk mbështeten në dokumentet arkivore vjeneze, por në të dhëna kishtare që i vinte në dyshim edhe Ilarion Ruvarac, duke shtruar pyetjen se si ishte e mundur që për bazë të merren shkrimet e një

edhe në letrën e 12 shtatorit të vitit 1634 Pjetër Mazreku do të përsëriste se besimtarët në ato zona ishin shqiptarë dhe sllavë. “*Nel territorio 4 milla anime in cinque parochie sotto la cura di due preti ma ve ne vorebbe un'altro, e qui per mancamento de sacerdoti si sono fatti turchi li popoli di 40, e piu parochie e questa gente ne per civilta e costume..*” Марко Јачов, *Список тајног Ватиканског Архива XVI-XVIII века* (Београд: Српска Академија Наука и Уметности, 1983), 51.

¹⁸ “*Intorno à Cossovo vi sono i seguenti luoghi... Il numero de combatenti in Servia ordinariamante ascende ad esser 3.000, in mille case cattoliche, quali congiunti coi Serviani ascendono al numero di X mille uomini; e molto disposti alla solevatione per le grandissime tiranie de Turchi.*” Augustino Theiner, *Vetera Monumenta Slavorum Meridionalium*, Tom. II, (Zagrabiae: Academia Scientiarum et Artium Slavorum Meridionalium, 1875), 221.

¹⁹ “*Li miei Albanesi si sono oferti in numero 300 soli d'impadronirsi del luogo senza spargimento di sangue; e se ivi sarà qualche alterazione tra popoli, la loro mira è di farsi forti.*” Augustino Theiner, *Vetera Monumenta Slavorum*, 221.

²⁰ Алекса Ивић, *Историја Срба у Војводини од најстаријих времена до оснивања пописко-поморишке границе (1703)*, (Нови Сад: Матица српска, 1929), 494.

murgu që nuk i mbështeste këto shifra në asnjë të dhënë, por edhe shtronte pyetjen se në kushte lufte a ishte e mundur zhvendosja e 37 000 familjeve?²¹

Vala e të shpërngulurve të tjerë pas vitit 1690

Në anën tjetër sipas raporteve që kishte pranuar Këshilli i Luftës më 1693 në Szentendre (Shën Andrea) kishin ardhur 12 000-14 000 rashjanë së bashku me 300 anije si dhe 6 000 rascian të tjerë në qytetin e Budimës.²² Ndërkohë në vitin 1694 në marrëveshjen ndërmjet Këshillit të Luftës të Perandorisë Habsburge dhe kryepeshkopit të Kishës Lindore, Arsenit III Cërnojeviq si dhe zëvendësdukës së milicisë rashjane, Joan Manastirit (Ioanni Monasterly) u vendos që edhe vala tjetër e të shpërngulurve të vendosen gjithashtu në rrethinën e qytetit Komárom (në veriperëndim të Mbretërisë së Hungarisë) dhe në disa pjesë të Sllovakisë, porse pjesa më e madhe e tyre të shpërngulen në Vllahinë e Vogël ose Banat (tokën ndërmjet lumenjve Tisa dhe Danub në pjesën juglindore të Mbretërisë së Hungarisë).²³ Studiuesi serb, Dushan Popoviq, në librin e tij “Срби у Будиму од 1690 до 1740” (Serbët në Budim nga 1690 deri në vitin 1740) shkruante se në Budim, serbët e shpërngulur jetonin në pjesën e quajtur nga hungarezët si “Racvaros” ose “Rajcenstat” nga gjermanët.²⁴ Sipas regjistrimit të popullsisë së Budimës të vitit 1720, këta banorë të shpërngulur kishin këtë prejardhje gjeografike: nga Beogradi 5 banorë (ndoshta edhe 6 banorë të tjerë), Uzhicë 7 banorë,

²¹ “...али главно је питање: да ли је тада збиља ирешило 37.000 породица, и откуд и како је то један прост јеромонах, који сам себе скитачем назива, могао дознати и сазнати...” Иларион Руварац, *Одломци о грофу Ђорђу Бранковићу и Арсенију Црнојевићу патријарху*, с три излета о такозваној великој сеоби српског народа (Београд: Српска краљевска академија, 1896), 99.

²² Алекса Ивић, *Историја Срба у Војводини*, 315, 505.

²³ Karl Freiherrn v. Czoernig, Beilagen (Sacrae Caesareae Regiaeque Hungariae et Bohemiae Majestatis, Domini Nostri Clementissimi Nomine Orientalis Ecclesiae Graeci Ritus Archiepiscopo, Domino Arsenio Csernovich et Rascianae Militiae Vice - Ductori Domino Ioanni Monasterly benigne assignandum. Per Imperatorem ex Consilio Bellico. Viennae, 31. Maii 1694.), 83; Banat's Denomination, <http://www.genealogy.ro/cont/1a.htm>. Qasja më 19 maj 2022.

²⁴ Душан Ј. Поповић, *Срби у Будиму од 1690 до 1740* (Београд: Српска књижевна задруга, 1952), 18.

Smederevë 6 banorë, Krushevcë 5 banorë, Pozharevcë 4 banorë, Paraqin, Maqvë dhe Starog Vllaha nga 3; Grocke, Jagodinë, Nishë, Pozhegë dhe Resavë nga 2; Aleksinac, Valevë, Zabrezhje, Zajeqar, Karanovcë, Kliqevcë, Kumodrazhë, Moravë, Palezhë, Podrinjë, Sokolë, Stalagjë, Cërne Bare, dhe “nga Serbia” nga 1 banorë. Në total ishin 70 banorë të ardhur nga Serbia.

Ndërsa nga “Serbia e Vjetër” sikur e quan ai territorin e Kosovës kishte më pak banorë në Budim dhe ata kishin këtë prejardhje: nga Peja 10 banorë; nga Kosova (nuk është e qartë a mendohet në Rrafshin e Kosovës ose vendbanimin me emrin Kosova) 6 banorë; Prizreni 4, Prijepole 3; nga Bjellopole, Vuçitërna, Pazari (mendohet në Novi-Pazar), Prishtina, Rashka dhe Suhodolli nga 1 banorë, që në total bënë 30 banorë të ardhur nga zona e Rrafshit të Kosovës dhe të Dukagjinit. Ndërsa nga Mali i Zi ishin 20 banorë, nga Bosnjë-Hercegovina 15 banorë, nga Maqedoni 4 banorë dhe Bullgaria 1 banorë.²⁵ Pra, sipas këtij regjistrimi në Budim jetonin 140 banorë të shpërngulur nga Serbia, Kosova, Mali i Zi, Maqedonia, Bullgaria dhe Bosnjë-Hercegovina nga të cilët vetëm rreth 20% ishin nga Rrafshi i Kosovës dhe i Dukagjinit. Pra edhe këto të dhëna statistikore nuk mbështesin tezën e historiografisë serbe mbi kinse “shpërnguljen e madhe serbe” nga Kosova që përshinte rreth 37 000 familje.²⁶

Prandaj çdo insistim i historiografisë serbe dhe të atyre që vazhdojnë ta mbështesin tezën se si shqiptarë në Rrafshin e Kosovës dhe të Dukagjinit në lëvizjen kryengritëse të viteve 1689-1690 pranohen vetëm shqiptarët e krishterë katolikë (të cilët nuk ishin banorë shumicë) dhe prezencën e shqiptarëve myslimanë (të konsideruar bashkëpunëtorë të osmanëve), njëkohësisht duke hedhur poshtë të dhënat e shumta që dëshmojnë për praninë e shqiptarëve të krishterë ortodoksë në sanxhakun e Shkupit, të Vuçitërnës, të Prizrenit dhe të Dukagjinit është vazhdimësi e narracionit historik serb që nga shekulli XIX e tutje.

²⁵ Душан Ј. Поповић, *Срби у Будиму*, 23.

²⁶ Павломъ Юлинцемъ, *Краткое введеніе въ історію происхожденія славено-сербскаго народа* (Венеција: Димитрије Теодосије, 1765), 156